

Aktualisht mban postin e Drejtorit të Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit dhe Sigurisë në Gjykatën e Lartë të Republikës së Shqipërisë. Ka lindur në vitin 1982, është i martuar dhe ka një vajzë.

Është diplomuar për Inxhinieri Elektronike në Universitetin e Inxhinierisë Pedagogjike dhe Teknologjike (ASPAITE), në Athinë, Greqi në vitin 2008. Në vitin 2009 ka përfunduar studimet Master në Inxhinieri Elektronike pranë këtij universiteti në Athinë. Ka punuar prej disa vitesh si inxhinier elektronik dhe mesues i inxhinierisë elektronike në shtetin Grek. Prej vitit 2009 – 2015 ka punuar si Koordinator i projekteve PAP, BKT, SCHOOL PROJECT dhe menaxher i Qendrës së Operimit, si edhe Drejtor Teknik në disa shoqëri shqiptare në fushën e telekomunikacionit dhe teknologjisë. Prej 5 vitesh ka ushtuar detyrën e specialistit të IT pranë Shkollës së Magjistraturës, deri në vitin 2020 e më pas këtë detyrë e ka ushtruar edhe pranë Këshilli të Lartë Gjyqësor.

Ka marrë pjesë në trajnime kombëtare e ndërkombëtare në fushën e Teknologjisë së Informacionit. Zotëron dy gjuhë të huaja: greqisht dhe anglisht.